



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
MINISTRIA E KULTURËS

MK prezanton projektin e parkut "Shokët dhe ëngjëjt"

2017-08-01 15:50:00



Në ambientet e MK u prezantua koncept-ideja e "Parku i Artit", një projekt që rivitalizon parkun natyror dhe kthen në një hapësirë arti. Projekti titullohet "Shokët dhe ëngjëjt", një projekt për një hapësirë-kopsht dedikuar Antonio Gramsci-t në qytetin e Tiranës. konceptuar nga Alfredo Pirri, artist dhe arkitekt me ekspozita ndërkombëtare. Në ambientet e MK u prezantua koncept-ideja e "Parku i Artit", një projekt që rivitalizon parkun natyror dhe kthen në një hapësirë arti. Projekti titullohet "Shokët dhe ëngjëjt", një projekt për një hapësirë-kopsht dedikuar Antonio Gramsci-t në qytetin e Tiranës. konceptuar nga Alfredo Pirri, artist dhe arkitekt me ekspozita ndërkombëtare.

Ministria e Kulturës, znj. Mirela Kumbaro u shpreh se :
"Prezantojmë këtë projekt-ide, e cila sjell një rifunksionalizim të parkut për një pol të ri kulturor dhe për të parë në dritën e filozofisë së Antonio Gramshit skulpturat e realizimit socialist. Ky do të jetë një debat i gjerë kulturor, lidhur me figurën e Antonio Gramshit".
Vetëm një vit e gjysmë më parë Ministria e Kulturës në bashkëpunim me Universitetet e Arkitekturës prezantoi konkursin për përshtatjen e territorit të ish-Kinostudios në Kopshtin e Artit. Qëllimi i projektit ishte krijimi i një hapësire ekspozitive të përkohshme dhe të përhershme për veprat e artistëve të rinj e më gjerë. Një ide e hershme në platformat kulturore të MK kthimi i territoreve të brendshme në një park për art dhe medium, për të gjitha stinët, për aktivitete sociale, kulturore e ekspozita të hapura, për ngjarje rinore e jo vetëm, pa kufij gjinësh dhe formash, madje edhe ato më të guximshmet.

Kumbaro shtoi se " Rikualifikimi i parkut në një skenë të hapur nuk është një koncept statik. Punojmë për rikualifikimin e Kinostudios, duke e sjellë jo vetëm një qendër zyresh, por edhe në një pol kulturor dhe social. Sot kemi disa institucione të artit duke filluar që nga QK e Fëmijëve e deri tek TKOBKVP. Morëm propozimin nga artisti Pirri për të krijuar një mesazh me një filozofi të caktuar. Ky projekt ka mbështetjen e Regione Puglia-s dhe Fondacionit "Antonio Gramsci".

Programi i përgjithshëm i projektit

Në disa fjalë të poemës së famshme të Antonio Gramsci-t me titull "La rosa di Turi" (Emri i vendit në të cilin ai qëndroi për një kohë të gjatë në burg gjatë fashizmit) frymëzoi titullin e veprës në fjalë: shokët dhe ëngjëjt.

Pirri : "Qëllimi është që Antonio Gramsci të kujtohet jo vetëm nëpërmjet 'një monumenti' po nëpërmjet realizimit të një hapësire publike të karakterizuar nga prania e artit por që ka edhe një vlerë qytetare dhe simbolike shumë të fortë: një "kopsht" që strehon brenda tij një instalacion të përhershëm që na jep një paraqitje mes natyrës dhe historisë". Një lloj peizazhi natyral në të cilin elementi i

egër dhe spontan i natyrës bashkohet me elemente botanikë dhe artistikë fuqimisht të projektuar në mënyrë të atillë që të krijojnë një ekuilibër në mes asaj që rritet në natyrë në mënyrë të mëvetësishme dhe formave të artit që janë në gjendje të dëshmojnë për integrimin me historinë dhe kulturën. Bëhet fjalë për një vend me vlerë që është tokë në pronësi publike e cila është ngjitur dhe i përket godinës së Ministrisë së Kulturës së Shqipërisë, aktualisht kjo tokë është thujse e braktisur dhe në pritje për t'u kthyer në një ambient publik. Kombinimi i emrit të Antonio Gramsci-t me një institucion shtetëror i nivelit më i lartë në fushën e kulturës, do të risillte, në një farë mënyre, në 'shtëpi' mendimtarin dhe politikanin e famshëm italian duke kontribuar në zgjerimin e rolit të atij që u konsiderua interpret absolut i cili për herë të parë reflektoi mbi rolin dhe detyrat e intelektualëve në kohët moderne dhe do ta bënte Shqipërinë vendin e parë në botë që i dedikon një vepër të qëndrueshme Antonio Gramsci-t, i cili aktualisht ka frymëzuar me dhjetëra nisma politike, kulturore dhe artistike në të gjithë botën por që mbeten vepra të momentit për të mos thënë (me qëllim por pozitivisht) jetëshkurtra.

Shokët dhe engjëjt

Projekt për një hapësirë-kopsht dedikuar Antonio Gramsci-t në qytetin e Tiranës.
Nga Alfredo Pirri
Vendi: Tiranë.
Vend në pronësi të Ministrisë së Kulturës të Republikës së Shqipërisë.
Shteti: Shqipëri.
Promotorët: Fakulteti i Arkitekturës i Universitetit të Firences
Ministra e Kulturës e Republikës së Shqipërisë

Ambasada e Shqipërisë në Itali
Rajoni i Puljes (Regione Puglia)
Fondacioni Gramshi (Fondazione Gramsci).